



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 269

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA  
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 17 MARS – 23 MARS 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

**SUBJEKT:** Kryeministria, Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministër i Shtetit për mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministër i Shteti për Standartet e Shërbimeve, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Bashkia Klos, Bashkia Korçë, Bashkia Pustec, Bashkia Lezhë.

**OBJEKTI:** Vlerësimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 17 mars deri më 23 mars 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

Në përfundim të këtij shqyrtimi

Data: 5.4.2023 Nr. 269  
Ora:12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 17 mars – 23 mars 2023”

## KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 17 mars deri më 23 mars 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 310 aktivitete, nga 64 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se, nga këto, 37 aktivitete të zhvilluara nga 15 institucione, janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Nga këto, janë ndaluar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve 7 (shtatë) aktivitete, të raportuara në shkelje të afatit ligjor të raportimit.

Në datë 24.3.2023, administrata e KQZ i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 30.3.2023, ora 11:00.

Palët e interesuara deponuan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Kryeministria ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
  - Aktiviteti “Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale do të kryejë inspektim lidhur me përfundimin e punimeve të spitalit të ri të sëmundjeve të brendshme. Gjatë këtij inspektimi do të marrë pjesë edhe Kryeministri SHTZ. Edi Rama”, raportuar më datë 19.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 22.3.2023
  - Aktiviteti “Event sensibilizues lidhur me rritjen e pagave dhe ndikimin e saj në mjedisin e biznesit, aktivitet në të cilin është ftuar të marrë pjesë edhe Kryeministri i vendit, SHTZ. Edi Rama”, raportuar më datë 23.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 27.3.2023

Kryeministria nëpërmjet email-it të datës 25.3.2023 ka sqaruar se: *Ju informoj se ne të dyja rastet e cituara prej jush, Kryeministria nuk është organizuese parësore e aktiviteteve. Kryeministri është i ftuar. Duke ju referuar agjendës së tij, si dhe duke vlerësuar prioritetet në angazhimet e tij të përditshme, është pranuar ftesa e paraqitur nga Institucionet organizuese të eventeve.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Kryeministria nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

2. Ministria e Brendshme ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Zv. Ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm prezantojnë Kryeinspektorin e ri të IKMT”, raportuar më datë 18.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 18.3.2023
- Aktiviteti “Ministri i Brendshëm shoqëron delegacionin zyrtar të KM, në kuadër të kësaj vizite, pritet të zhvillojë një bisedë me homologen e tij, për të bashkëbiseduar mbi statusin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe në fushën e sigurisë, si dhe zbatimin e marrëveshjeve në fuqi mes dy vendeve”, raportuar më datë 20.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 24.3.2023

Ministria e Brendshme, nëpërmjet emailit të datës 27.3.2023, ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Lidhur me konstatimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për aktivitetet e raportuara nga Ministria e Brendshme, në periudhën 17 mars–23 mars 2023, me argumentin se janë veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, në cilësinë e zyrtarit raportues të Ministrisë së Brendshme, ju bëj me dije se:*

*Së pari, në datë 18 mars, është raportuar aktiviteti “Zv/ministri dhe Sekretari i Përgjithshëm prezantojnë Kryeinspektorin e ri të IKMT”. Raportimi është kryer në datën 18 mars për një event të datës 18 mars, por ky raportim është kryer në kushtet e pamundësisë së parashikimit korrekt kohor, pasi emërimi i Kryeinspektorit mban datën 17 mars. Pra, nuk ka patur asnjë mundësi reale kohore për të respektuar procedurën 5 ditore të njoftimit në KQZ, në periudhën zgjedhore. Gjithashtu, duke patur parasysh këtë, nuk u publikua njoftimi në media apo në rrjetet sociale të Ministrisë së Brendshme për këtë aktivitet, duke mos sjellë pasoja. Pra, megjithëse KQZ është njoftuar për aktivitetin, nuk u publikua duke konsideruar afatin e shkurtër kohor.*

*Së dyti, në datë 20 mars, është raportuar aktivitetin “Ministri i Brendshëm shoqëron delegacionin zyrtar të KM, dhe në këtë kuadër pritet të takojë homologen britanike” për tu zhvilluar në datë 24. Dhe duke i qëndruar shumë korrekt afatit kohor të publikimit të eventit, në datën 25 mars në ora 11:29, Ministria e Brendshme ka publikuar njoftimin për takimin e zhvilluar në Londër, në grupin e komunikimit të MB, ku janë pjesë 157 gazetarë. Pak minuta më vonë, në datë 25 mars, është publikuar në rrjetet sociale njoftimi për takimin, së bashku me mesazhet përkatëse. Pra, është respektuar me rigorozitet afati 5 ditor, i përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se Ministria e Brendshme për aktivitetin e parë, nuk ka patur mundësi faktike për raportim.

Përsa i përket aktivitetit të dytë, konsiderohet që është një veprimtari që nuk është organizuar nga ky institucion, por ka patur pjesëmarrjen e Ministrit të Brendshëm, si pjesë e delegacionit zyrtar të Kryeministrit në takim me homologen britanike, takim i zhvilluar në Londër, Britaninë e Madhe. Në kushtet që ka qënë në cilësinë e të ftuarit, nuk ka patur as detyrim për raportim në ndërfaqen e KQZ-së.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Takim me Punonjësit e parë socialë të licensuar”, raportuar më datë 17.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 21.3.2023
- Aktiviteti “Takim me mjekët e punësuar nga portali “Mjekë për Shqipërinë”, raportuar më datë 17.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 21.3.2023
- Aktiviteti “Ripublikim-Inagurim i Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme”, raportuar më datë 17.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 21.3.2023

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet emailit të datës 29.3.2023 ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Në lidhje me Aktivitetin "Ripublikim-Inagurim të Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme" sqarojmë se ky aktivitet është ripublikuar në datën 17.3.2023 për t’u zhvilluar në datën 22.3.2023 në ndërfaqen e KQZ, brenda 5-ditëve të parashikuara. (më poshtë linku i postimit)*

<https://aktivitete.kqz.gov.al/2023/03/17/ripublikim-inaqurim-i-spitalit-te-semundjeve-te-brendshme/>

*Sa i përket dy aktiviteteve të tjera të sjella në vëmendje, raportuar në datë 17.3.2023 për t’u zhvilluar në datë 21.3.2023, sqarojmë se keto aktivitete janë tentuar të publikohen ditën e enjte në datën 16.3.2023, dhe është vënë re dhe nga ana jonë se këto dy publikim, specifikisht, nuk kanë qenë të ruajtura në ndërfaqe për shkak të problematikave me sistemin. Në këto kushte, në kuadër të detyrimit për të raportuar cdo aktivitet me karakter publik, këto dy aktivitete të sipërpërmendura nuk janë raportuar në përputhje me afatet e përcaktuara.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet, vlerëson se në lidhje me aktivitetin e tretë, është bërë riraportim i zhvillimit të veprimtarisë, brenda afateve ligjore të parashikuara.

Lidhur me dy aktivitetet e tjera, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pretendon se ka patur probleme me sistemin e ndërfaqes dhe nuk ka mundur të kryejë më herët raportimin. Pavarësisht kësaj, sikundër parashikon neni 4 i vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, në rastet kur institucioni e ka të pamundur teknikisht aksesimin e ndërfaqes, mund të dërgojë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, tërheq vëmendjen Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që në vijim të kryejë raportimet duke respektuar afatin 5 (pesë) ditor të përcaktuar në ligj.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën që do të zhvillohet lidhur me Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Parandalimin e mbetjeve Detare në Ballkanin Perëndimor”, raportuar më datë 20.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 23.3.2023
- Aktiviteti “Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën që do të zhvillohet në kuadër të programit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Parandalimin e Mbetjeve Detare në Ballkanin Perëndimor”, raportuar më datë 20.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 24.3.2023
- Aktiviteti “Ftesë për pjesëmarrje në shfaqjen e filmit “Dante” me rastin e Ditës Kombëtare dedikuar Dante Aligherit”, raportuar më datë 20.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 24.3.2023

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet email-it të datës 28.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Referuar e-mailit të mëposhtëm, lidhur me aktivitetet e zhvilluara në datat 23/24 me pjesëmarrjen e zj. Almira Xhembulla në pozicionin zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit dhe datë 24 (shfaqja e filmit Dante) me pjesëmarrjen e zj. Vilma Bello në pozicionin zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, ju bëjmë me dije se, këto aktivitete janë organizuar nga institucione të tjera dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka qenë organizuese e tyre. Gjithashtu, zj. Xhembulla dhe zj. Bello kanë qenë të ftuara për të marrë pjesë në këto aktivitete. Për shkak të agjendës së ngarkuar të punës, ka qenë e vështirë konfirmimi i pjesëmarrjes në këto aktivitete, dhe si rrjedhojë ka sjellë vonesë në publikimin e tyre. Menjëherë pas konfirmimit të pjesëmarrjes nga ana e zj. Bello dhe zj. Xhembulla kemi raportuar në faqen e KQZ-së.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

5. Ministria e Kulturës ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Konferencë shtypi për Baletin Paganini me koreografinë dhe Shkollën e Baletit”, raportuar në datë 17.3.2023 për tu zhvilluar në datë 18.2.2023

Ministria e Kulturës, nëpërmjet email-it të datës 27.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Veprimtaria e sipërcituar është një veprimtari e cila nuk organizohet nga Ministria e Kulturës, por*

*nga Shkolla e Baletit. Raportimi nga ana e Ministrisë së Kulturës është kryer në datën 17.3.2023, datë në të cilën Ministria e Kulturës ka marrë ftesën në cilësinë e të ftuarit në këtë aktivitet. Pavarësisht se ky aktivitet nuk është organizuar nga ana e Ministrisë së Kulturës, në konsideratë të parashikimit lidhur me raportimin e veprimtarive publike 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, ju bëjmë me dije se nga ana jonë është njoftuar me përgjegjshmëri ligjore në të njejtën datë në të cilën Ministres së Kulturës i është konfirmuar aktiviteti.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Ministria e Kulturës nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

6. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Pjesëmarrje në aktivitetin “Java e teknologjisë Tirana Tel Aviv”, raportuar më datë 17.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 21.3.2023

Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me këtë aktivitet.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, nga hetimi i kryer dhe nga të dhënat e raportuara në ndërfaqen e KQZ-së, vlerëson se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes është në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

7. Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti “Mbledhje e Komitetit OGP (Ripublikim)”, raportuar më datë 20.3.2023 për t’u zhvilluar më datë 24.3.2023

Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, nëpërmjet email-it të datës 27.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në vijim të e-mailit tuaj si më poshtë shpjegoj, Aktiviteti "Mbledhje e Komitetit OGP" është raportuar më datë 17.3.2023 dhe për arsye të*

mosfunksionimit të sistemit, nuk ishte shfaqur në faqen "Aktivitete" të KQZ. Për këtë arsye, u ripostua në datë 20.3.2023. Sqarohet se aktiviteti është postuar në rrjetet sociale sot (datë 27.3.2023), lutem gjeni më poshtë link-un:

<https://www.facebook.com/100050311187105/posts/pfbid02UDD4va7hëqQGesXXMEYQXY6ëQJNBY2j6Hv5Pnc8FTZiPtpAq8fHzDJdh1nE5jPZh/?mibextid=cr9u03>

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura konstaton se në këto kushte, duke mirëkuptuar rastet e problematikave që shkakton sistemi në ndërfaqe, tërheq vëmendjen Ministrit të Shtetit për Standartet dhe Shërbimet që në vijim, kur është i pamundur teknikisht aksesimi i ndërfaqes, të dërgojnë raportimin nëpërmjet email-it zyrtar ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar brenda afatit ligjor.

8. Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti "Forumi Ekonomik Austriak me rastin e vizitës së Presidentit të Republikës Federale të Austrisë, SH.T.Z. Alexander Van der Bellen", raportuar më datë 23.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 27.3.2023
- Aktiviteti "Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Kryeministrinë do të zhvillojnë bashkarisht një event sensibilizues me Komunitetin e Biznesit në sektorin e ndërtimit lidhur me rritjen e pagave dhe ndikimin e saj në mjedisin e biznesit", raportuar më datë 23.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 27.3.2023

Ministria e Financës dhe Ekonomisë, nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me shkeljet e konstatuara.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura në lidhje me aktivitetet e raportuara konstaton se për shkak të tematikës së tyre nuk kanë detyrim për raportim pasi janë veprimtari funksionale të institucionit, me pjesëmarrje delegacionesh të huaja, për të cilat duhet marrë konfirmim nga ana e pjesëmarrësve për zhvillim të këtyre veprimtarive. Në të tilla raste, mirëkuptohet situata e krijuar.

9. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti "Në kuadër të Ditës Botërore të Ujit, 22 mars, kemi menduar të zhvillojmë një aktivitet me Kopshtin nr. 25/1 (kopsht publik) në Tiranë, me grupin parashkollor", raportuar në datë 17.3.2023 për tu zhvilluar në datë 21.3.2023

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nëpërmjet email-it të datës 27.3.2023 ka paraqitur pretendimet e veta dhe ka sqaruar se: *Referuar emailit të dërguar nga ju, lidhur me shkeljen*

Data: 5.4.2023 Nr. 269  
Ora:12:00



"Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 17 mars – 23 mars 2023"

*për afatet e raportimit të aktivitetit "Në kuadër të Ditës Botërore të Ujit 22 mars 2023" në kopshtin nr. 25/1 Tiranë, ju bëjmë me dije se aktiviteti i zhvilluar në datën 21 mars 2023 është bërë nga Agjencia Austriake e Zhvillimit, në kuadër të projektit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit të Mbështetjes për Menaxhimin e Integruar të Ujit në Shqipëri, financuar nga Bashkimi Europian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. Duke qënë se e gjithë baza materiale e nevojshme dhe facilitetet për zhvillimin e aktivitetit u mundësuan nga Agjencia Austriake për Zhvillim, në datën 17.3.2023 u njoftuam mbi zhvillimin e aktivitetit. Si rrjedhim, për të qënë brenda dispozitës dhe detyrimit që përcaktohet në nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator mbi raportimet e të gjitha aktiviteteve me karakter publik, vendosëm të raportojmë aktivitetin. Duke kërkuar ndjesë për afatin, ju sigurojmë që nuk do të përseritet në raportime të tjera një rast i tillë.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nuk ka pasur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se nuk është në cilësinë e organizatorit në këtë event por në cilësinë e të ftuarit nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Sipas nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

10. Bashkia Korçë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 10 (dhjetë) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktiviteti "Inspektim në kanal in e ujërave të malit në fshatin Drenovë", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 20.3.2023
2. Aktiviteti "Në kuadër të ditës ndërkombëtare të pyjeve, Bashkia Korçë i bashkohet nismës së Korca-Alpin për të shtuar gjelbërimin e Parkut Kombëtar "Bredhi i Drenovës", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 21.3.2023
3. Aktiviteti "Kryetari i Bashkisë Korçë do të bëjë inspektim punimesh në kanal in kryesor të Gjancit", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 21.3.2023
4. Aktiviteti "Kryetari i bashkisë do të takohet me fermeret e njësisë administrative Mollaj, për të diskutuar mbi aplikimet e skemave të naftës", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 21.3.2023
5. Aktiviteti "Kryetari i bashkisë do të bëjë inspektime në fshatin Pulahë", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 21.3.2023
6. Aktiviteti "Kryetari i bashkisë do të marrë pjesë në një aktivitet të organizuar nga "Qyteza e Fëmijë", në perfundim të së cilit do të ndaje cmimet", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 21.3.2023
7. Aktiviteti "Takim me gra të lagjes nr. 4 të qytetit", raportuar më datë 17.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 21.3.2023



8. Aktiviteti "Gjimnazi Platon fton kryetarin e bashkisë të marrë pjesë në shfaqjen e organizuar në nderim të festes kombëtare të "25 Marsit 1821", raportuar më datë 20.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 23.3.2023
9. Aktiviteti "Gjimnazi Platon fton kryetarin e bashkisë të marrë pjesë në shfaqjen e organizuar në nderim të festës kombëtare të "25 Marsit 1821", raportuar më datë 20.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 23.3.2023
10. Aktiviteti "House of Horses fton kryetarin e bashkisë Korçë të ndjekë garën e kuajve me pengesa", raportuar më datë 21.3.2023 për t'u zhvilluar më datë 25.3.2023

Bashkia Korçë, nëpërmjet emailit të datës 27.3.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *Në përgjigje të email-it tuaj mbi raportimin e disa prej veprimtarive publike përtej afatit ligjor, kërkojmë ndjesë, duke qenë se kemi përlogaritur gabim ditët para raportimit, pasi dita e pestë është dita e zhvillimit të aktivitetit. Në lidhje me dy aktivitetet: 1. "Ftesë për pjesëmarrje në aktivitet nga gjimnazi Platon" dhe 2. "Ftesë për pjesëmarrje në garën e kuajve me pengesa", raportimin e kemi bërë jashtë afatit ligjor për shkak se ftesat për pjesëmarrje kanë ardhur me vonesë. Për këtë arsye ju kemi njoftuar me email për t'ju vendosur në dijeni. Bashkangjitur po ju dërgojmë email-et për të bërë verifikimet.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura vlerëson se në lidhje me aktivitetet 8/9/10, kryetari i Bashkisë Korçë ka qenë i ftuar dhe nuk ka detyrim për raportim.

Për shtatë aktivitetet e tjera, duke ju referuar rrethanave dhe fakteve të paraqitura krijoi bindjen se aktivitetet e raportuara me vonesë kanë ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar të dispozitës ligjore të afatit 5 (pesë) ditor, duke përfshirë në llogaritje edhe ditën e zhvillimit të aktivitetit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, tërheq vëmendjen Bashkisë Korçë në vijim të kryejë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

11. Bashkia Klos ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1(një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktiviteti "Kryetari i Bashkisë Klos inspekton punimet e urës në hyrje të Qytetit të Klosit", raportuar më datën 20.3.2023 për t'u zhvilluar më datën 20.3.2023

Bashkia Klos nëpërmjet email-it të datës 28.3.2023 ka paraqitur pretendime në lidhje me këtë aktivitet dhe ka sqaruar se: *Ne si institucion, nuk kemi arritur të kishim akses në raportimet e KQZ pasi email-i i bashkëngjitur për të kryer këtë proces, ka qënë jo i aksesueshëm nga ana ime. Vetëm pak para ditësh, kam mundur ta rikthej emailin dhe aksesova për të raportuar. Duke qënë se është hera e parë e aksesimit në raportimet e KQZ, posti i raportuar ishte një lapsus nga ana ime dhe për këtë kërkoj ndjesë. Menjëherë pas klikimit për publikim e kuptova lapsusin që kisha bërë por ishte i*

*pamundur korigjimi i tij, pasi ishte publikuar. Nëse është e mundur, nga ana e komisionerit të merret parasysh lapsusi, i cili është bërë, dhe në rast se ky gabim përsëritet, kërkoj nga ana juaj dhënien maksimale të dënimit administrativ. Mbetem me shpresë, që kërkesa ime të merret në konsideratë nga ana juaj.*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, krijoi bindjen se aktiviteti i raportuara me vonesë kanë ardhur si pasojë e një gabimi të kryer gjatë raportimit. Për këtë arsye, duke mirëkuptuar situatën e krijuar nga moskuptimi i drejtë i ligjit, tërheq vëmendjen Bashkisë Klos, në vijim të kryejë llogaritjen e afatit 5 ditor sipas nenit 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton shprehimisht se raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 5 ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë.

12. Bashkia Pustec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

-Aktiviteti “Organizimi i ndeshjeve të futbollit midis fshatrave të Bashkisë Pustec”, raportuar më datën 23.3.2023, për t’u zhvilluar më datë 15.3.2023

- Aktiviteti “Inspektim Punimesh në oborin e Shkollës së mesme të Bashkuar Pustec”, raportuar më datën 23.3.2023, për t’u zhvilluar më datë 24.3.2023

Bashkia Pustec, nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me zhvillimit e këtij aktiviteti.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar rrethanave dhe fakteve të raportuara në ndërfaqe dhe hetimit të kryer, vlerëson se për shkak të tematikës së aktivitetit të parë “ndeshje futboll”, nuk përbën detyrim për raportim të veprimtarisë. Përsa i përket veprimtarisë “Inspektim Punimesh në oborin e shkollës së mesme të Bashkuar Pustec”, nuk ka patur prezencë të publikut, një veprimtari në kuadër të detyrave të veta funksionale. Në këto kushte nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

12.Bashkia Lezhë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon

- Aktiviteti “Inspektim për fillimin e punimeve të rrugëve në fshatin Spiten”, raportuar më datë 17.3.2023 për tu zhvilluar më datë 23.2.2023

Bashkia Lezhë nuk ka paraqitur pretendime në lidhje me këtë aktivitet.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura vlerëson se është bërë një lapsus në hedhjen e datës që është planifikuar për tu zhvilluar veprimtaria. Në kushte të tilla, duke mirëkuptuar problematikat që lindin gjatë raportimit në ndërfaqe, nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
  - a) Kryeministria
  - b) Ministria e Brendshme
  - c) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
  - ç) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
  - d) Ministria e Kulturës
  - dh) Ministria e Financës dhe Ekonomisë
  - e) Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
  - ë) Ministër i Shteti për Standartet e Shërbimeve
  - f) Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
  - g) Bashkia Klos
  - gj) Bashkia Korçë
  - h) Bashkia Pustec
  - i) Bashkia Lezhë.
- 2) Ky vendim t’u njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**